



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 27.5. 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe
Mbiqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë;
Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Përfaqësuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme: Valdet Hoxha, zëvendësministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Naim Rexha, zëvendës drejtor i Policisë së Kosovës; Artan Dreshaj, drejtor i Departament për Administrim të Sistemeve dhe Komunikimeve-MPB; Dardan Kocani-UD, Departamenti për Integritet Evropian në MPB; Fadil Abdyli, shef i Sektorit për Hetime, Krime Kibernetike në Policinë e Kosovës.

Pjesëmarrës të tjetër: Luanda Domi, DCAF.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më datë 20.4.2016 dhe 29.4.2016;

3. Raportimi nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme rreth zbatimit të dokumenteve strategjike të sigurisë;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më datë 20.4.2016 dhe 29.4.2016

Procesverbalet u miratuan me vërejtje.

Nga z. Bojan Mitiq u bë vërejtje në cilësinë e përkthimit.

3. Raportimi nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme rreth zbatimit të dokumenteve strategjike të sigurisë

Kryesuesi- Fillimisht, theksoi se Komisioni, në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor që ka në fushën e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë, ka paraparë të organizojë këtë seancë dëgjimore lidhur me zbatimin e dokumenteve strategjike të sektorit të sigurisë, me theks të veçantë për strategjitë si në vijim: Strategjia Kundër Krimin të Organizuar; Strategjia Kundër Terrorizmit; Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca; Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë; Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit, që shpie në terrorizëm dhe Strategjia Shtetërore për Siguri Kibernetike. Më tutje, theksoi se raportimi duhet të jetë i fokusuar në rezultatet e zbatimit, nivelin e zbatimit dhe sfidat në këtë drejtim. Fjalën ua dha përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Valdet Hoxha, zëvendësministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme (koordinator Kombëtar)- Në fillim të fjalës së tij, theksoi se do të raportojë për Strategjinë Kundër Krimin të Organizuar dhe Strategjinë Kundër Terrorizmit. Sa i përket Strategjisë Kundër Terrorizmit, theksoi se kjo strategji është miratuar në vitin 2012 dhe vlen deri në vitin 2017. Me këtë strategji, janë përcaktuar objektivat strategjike dhe me anë të aktiviteteve synohet arritja e këtyre objektivave. Më tutje, theksoi se kjo strategji e ka edhe planin e punës, i cili rishikohet çdo vit, sipas nevojave dhe sfidave që dalin. Si strategji e ndjeshme, është një mekanizëm që bën që të realizohet kjo strategji dhe se në këtë mekanizëm bëjnë pjesë: Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Policia e Kosovës, ministri të ndryshme dhe agjenci dhe mekanizma të tjerë. Duke u bazuar në bashkëpunimin që ekziston mes këtyre institucioneve, theksoi se kjo strategji, deri tani, është realizuar në masën 75%, ndërsa pjesa tjetër është paraparë të realizohet në vazhdimësi. Nga ana e AKI-së, në vazhdimësi, përpilohen raporte dhe profile të njerëzve, grupeve dhe institucioneve që mund të jenë rrezik potencial që shpijnë në ekstremizmin e

dhunshëm apo akteve terroriste, dhe në bazë të këtyre informacioneve të mbledhura nga AKI-ja, institucionet tona kanë informata të plota për grupet e caktuara. Gjithashtu, është nevojë e kohës që këto informata të ndahen në mes të mekanizmave të sigurisë. Po ashtu, Policia e Kosovës i ka njësitet e veta të inteligjencës dhe bazohet në konceptin e policisë së udhëhequr nga intelijenca, dhe përveç që ka listën e njerëzve dhe organizatave që janë rrezik potencial për terrorizmin, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, në vazhdimësi përditësohen të dhënat përmes burimeve të tyre. Po ashtu, rol i rëndësishëm i kushtohet parandalimit të terrorizmit, ku për këtë qëllim janë organizuar ligjërata të ndryshme në shkolla. Gjithashtu, ekziston një bashkëpunim i mirë në mes të Policisë së Kosovës, doganave dhe agjencive tjera të zbatimit të ligjit. Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është krijuar Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, ku monitorohen me kamera njëzet e katër orë, me qëllim të kontrollimit dhe parandalimit të veprimeve të grupeve radikale.

Policia e Kosovës, tashmë ka të identifikuarat zonat dhe qytetet ku përkrahet ideologjia e ekstremizmit të dhunshëm, qoftë edhe ai fetar. Gjithashtu, mekanizmat e sigurisë së brendshme kanë raporte dhe marrëveshje bashkëpunimi edhe me mekanizmat ndërkombëtarë, ku marrëveshje bashkëpunimi ekziston me Republikën e Sllovenisë, Turqisë, Shqipërisë, ndërsa nga ana e inteligjencës financiare, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shtetin e Ganës dhe Hungarisë. Sipas të dhënave që posedon Policia e Kosovës, në tetë muajt e fundit, asnjë qytetar i Republikës së Kosovës, nuk ka shkuar të luftojë në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme. Nga fillimi i këtyre luftërave dhe deri më sot, janë të identifikuar 314 vullnetarë, të cilët kanë shkuar në zonat e luftës, ndërsa 40 prej tyre, është arritur që të ndalohen nga ana e Drejtorisë Kundër Terrorizmit. Aktualisht, në zonën e Sirisë dhe Irakut, janë aktivë rreth 70 luftëtarë, ndërsa llogariten afër 57 shtetas të Kosovës që kanë vdekur në zonat e luftës, ndërsa mekanizmat e sigurisë në Kosovë e kanë situatën nën kontroll. Nga viti 2013, janë iniciuar 199 hetime për personat me ideologji me prirje ekstremiste, janë arrestuar 102 persona, kallëzime penale ndaj 199 personave, janë ngritur aktakuza, pas zhvillimit të hetimeve për 70 persona, ndërsa janë dënuar 34 persona për këto vepra. Sa i përket sfidave, me të cilat përballen mekanizmat e sigurisë në Kosovë, janë për shkak të specifikës së fushës, siç është ngritja e kapaciteteve dhe ndarja e informatave.

Së fundmi, do të mbahet edhe Bordi për anëtarësim në INTERPOL, pasi është aplikuar për anëtarësimin në këtë organizatë policore dhe besojmë se do të kemi vlerësim pozitiv. Ndërsa, derisa të anëtarësohemi në INTERPOL, në Policinë e Kosovës është Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar (ILEKO), përmes së cilës komunikohet me të gjithë mekanizmat e sigurisë të botës.

Bojan Mitiq- Falënderoi përfaqësuesit e MPB-së për raportimin. Duke iu referuar fjalës së z. Hoxha, që në luftën kundër terrorizmit janë të ndërlidhura shumë institucione, shtroi pyetjet si në vijim: A janë të përfshira edhe shkollat ku ka edhe komunitete serbe? Nëse po, deri në çfarë mase janë të ndërlidhura, dhe nëse jo, pse nuk ka ndodhur?

Nuredin Ibishi- Shtroi pyetjet si në vijim: Ndaj personave që janë aktualisht në vuajtje të dënimit, a janë ndërmarrë masa që të rikthehen si të riedukuar? A mendoni që aspekti i bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm është i kënaqshëm, në aspektin e shkëmbimit të informacioneve?

Anton Quni- Cila është e përbashkëta e pjesëmarrësve në luftërat në Siri dhe Irak? Cili është profili i tyre arsimor, edukativ etj. ?

Ganimete Musliu- Lidhur me këtë strategji, parashtroi pyetjet si në vijim: Sa kohë ka që jeni përcaktuar si koordinator Kombëtar për këtë strategji? Çfarë masash janë paraparë në Strategjinë Kundër Krimin të Organizuar dhe Strategjinë për parandalimin veprimeve terroriste?

Kryesuesi- A ka paraparë Ministria e Punëve të Brendshme ndonjë strategji për parandalimin e propagandës së fuqishme që është bërë në raport me vendin tonë, Kosovën?

Valdet Hoxha, zëvendësministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme (koordinator Kombëtar) - Sa i përket fushatës së vetëdijesimit në shkolla, theksoi se sensibilizimi është bërë për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim etnie dhe janë mbajtur një sërë ligjëratash edhe me mbështetjen e ICITAP-it. Ndërsa, në përgjigje të pyetjes së z.Nurdin Ibishi, theksoi se nuk ndalet qasja proaktive, që nga momenti i fillimit të përcjelljes së rasteve dhe personave të caktuar, pra është një qasje konsistente. Në përgjigjeje të z. Anton Quni, theksoi se në vazhdimësi është raportuar për shkaqe që kanë çuar në radikalizëm, ndër shkaqet janë: papunësia, njohuritë e pakta fetare, niveli i ulët i shkollimit. Ndërsa, sa i përket komunikimit me mekanizmat e sigurisë, të rajonit dhe më gjerë, theksoi se ekziston, sidomos me Turqinë dhe falë këtij bashkëpunimi, është arritur të ndalohen 40 persona, që janë nisur për të luftuar në Lindjen e Mesme. Në përgjigje të pyetjes së znj. Ganimete Musliu, theksoi se koordinator për këtë strategji është emëruar gjatë këtij muaji, ndërsa sa i përket masave të ndërmarra për sulmet e mundshme terroriste, theksoi se konsistenca e veprimeve të policisë, në asnjë fazë nuk parashihet që të përfundojnë, që nga momenti i identifikimit të profilit të personit, arrestimit apo burgosjes, dhe në bazë të informatave dhe raportimeve që i janë bërë, theksoi se të gjithë mekanizmat kanë garantuar që janë të sigurt në veprimet e tyre drejt parandalimit të akteve të tilla.

Në përgjigje të z. Fadil Demaku, që ekziston tendenca e propagandës që mund të prishë imazhin e Kosovës, theksoi se Kosova ka partnerë ndërkombëtarë dhe se bashkëpunimi është i vazhdueshëm me ta. Gjithashtu, theksoi se Ministria e Punëve të Brendshme, nuk ka një strategji të tillë që t’iu kundërvihet deklarimeve të shteteve, individëve apo organizatave të ndryshme. Këtë mundohet ta realizojë përmes mjeteve të informimit dhe përmes mekanizmave të sigurisë.

Duke qenë se është koordinator Kombëtar për Strategjinë Kundër Krimin të Organizuar, theksoi se kjo strategji i ka aktorët e njëjtë, sikurse strategjia e sipërpërmendur dhe është ombrellë për strategjitë e tjera në vend dhe ka afat të implementimit, deri në vitin 2017 dhe merret me fazën e ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe teknike, në kuptim të luftimit të krimin të organizuar. Edhe kjo strategji, në bazë të analizave të grupit punues, është vlerësuar që është realizuar deri në 74 për qind, ndërsa pjesa tjetër do të realizohet sipas aktiviteteve të parapara.

Aktorë kryesorë edhe në këtë strategji, janë: Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Forca e Sigurisë së Kosovës, Njësi i Inteligjencës Financiare dhe mekanizma të tjerë. Sa i përket objektivit të fuqizimit të mëtejshëm të kapaciteteve, të gjithë mekanizmat kanë bërë vlerësimin e personelit dhe janë në rrugë të mirë, duke zhvilluar trajnime për ngritjen e kapaciteteve. Ndërsa, më kuadër të luftës së krimin të organizuar, Policia e Kosovës dhe mekanizmat e tjerë të sigurisë, kanë marrëveshje bashkëpunimi me mekanizmat vendorë dhe me vendet e rajonit, ku realizohen patrullime të përbashkëta, marrëveshje bashkëpunimi mes shteteve në ndarjen e informatave në kohë reale. Me qëllim të zbatimit të kësaj strategjie, nga ana

e Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë paraqitur disa nisma për miratim në Qeveri, të cilat janë miratuar dhe kanë të bëjnë me lidhjen e marrëveshjeve për bashkëpunim policor në luftimin e krimit dhe terrorizmit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, të Italisë, Mbretërisë së Danimarkës, Belgjikës, Lituanisë dhe të Estonisë. Këto marrëveshje kanë marrë dritën e gjelbër nga Qeveria e Kosovës dhe tani janë në fazën e zbatimit. Aspekt tjetër i bashkëpunimit, janë edhe operacionet e përbashkëta me shtetet e tjera, siç është rasti “RANDO”, ku Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me shtatë shtete evropiane, janë arrestuar 78 persona të dyshuar, 17 prej tyre nga Kosova, që kanë pasur të bëjnë me organizimin e emigrimit ilegal.

Më tutje, paraqiti disa rezultate konkrete, të arrira nga mekanizmat e sigurisë, duke u bazuar në konceptin e policisë së udhëhequr nga inteligjenca dhe se shumë raste janë drejtuar në Prokurorinë e Shtetit, me kualifikimin si krimi organizuar. Gjendja e fundit në Prokurorinë e Shtetit është: nga gjashtëmbëdhjetë raste për krim të organizuar, janë duke u hetuar njëqind e pesëdhjetë persona, nga këta persona, ndaj 95 prej tyre janë pushuar hetimet, ndërsa për 55 persona është ngritur aktakuzë për krim të organizuar. Gjithashtu, theksoi se janë 31 raste, për të cilat zhvillohen hetime, që janë raste të profilit të lartë dhe janë paraqitur si obligim në çështjen e integriteteve. Në mesin e 31 rasteve që janë hetuar, për 16 prej tyre janë ngritur aktakuza, ku një aktakuzë përfshin më shumë se një person, ndërsa 15 raste të tjera me 240 persona të përfshirë në të, janë në procedurë të hetimit. Nga ana e Policisë së Kosovës, është paraqitur raporti për shkatërrimin e 31 grupeve kriminale, dhe së fundmi, ka një intensitet të mekanizmave të sigurisë dhe është duke u aplikuar sekuestrimi (ngrirja e aseteve).

Sfidë mbetet ndarja e informatave, bashkëpunimi me aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, por shtoi se institucionet e vendit janë në rrugë të duhur.

Ganimete Musliu- Shtroi dy pyetje si në vijim: A është kriter për të qenë mashkull, që të jesh koordinator Kombëtar për strategjitë? Duke qenë se strategjia për të cilën raportoni, ka 4 vite që është miratuar dhe pjesa më e madhe është realizuar, cilat kanë qenë sfidat e hasura gjatë zbatimit të planit të punës për këtë strategji?

Nuredin Ibishi- Shtroi çështjen, që përveç të arriturave të deritanishme, sa ka gjetur zbatim Strategjia, Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca, duke qenë se është identifikuar si sfidë në Raportin e Progresit?

Valdet Hoxha, zëvendësministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme (koordinator Kombëtar)- Në përgjigjeje të pyetjeve të znj .Ganimete Musliu, theksoi se në aspektin gjinor nuk e kanë menduar, ndërsa sfidat gjatë zbatimit të strategjisë, kryesisht janë në aspektin e koordinimit, komunikimit. Për këtë arsye, janë planifikuar disa projekte për integrimin e bazës së të dhënave. Ndërsa, në përgjigje të z. Nuredin Ibishi, theksoi se çdo aksion dhe plan operacional, zhvillohet në bazë të këtij koncepti.

Naim Rexha, zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (koordinator Kombëtar)- Lidhur me Strategjinë e Policisë së Udhëhequr nga Inteligjenca, theksoi se koncepti i policisë së udhëhequr nga inteligjenca, si koncept bashkëkohor, tek ne ende konsiderohet i ri, pasi që është në zëvendësim të konceptit të policimit në bashkësi. Fillimin e ndërtimit të këtij koncepti, Policia e Kosovës e ka nga viti 2010, ku është hartuar strategjia e parë për hartimin e këtij koncepti në afatin tre vjeçar. Kjo strategji është e dyta me radhë dhe ka shtrirje gjatë viteve

2013-2017, e hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Më tutje, theksoi se sot në Policinë e Kosovës, janë duke u vlerësuar objektivat e arritura, ku në kuadër të katër objektivave strategjike, strategjia parasheh gjashtëdhjetë objektiva strategjike dhe se objektivat të cilat kanë qenë të afatizuara, janë realizuar. Po ashtu, në vazhdimësi, jemi në realizim të objektivave të klasifikuara, që janë njëzet e shtatë.

Më tutje, theksoi se kjo strategji zbatohet duke u udhëhequr nga një grup i zbatimit dhe përbrenda grupit të tillë, ka segmente të caktuara sipas fushave të nevojshme. Si rezultate përfundimtare dhe të arritura në fund të 2015-s, është fillimi i zbatimit të sistemit të integruar të Policisë së Kosovës, sistemi teknologjik “PRIMS” dhe janë raportet e hartuara për krimin e organizuara dhe serioz dhe vlerësimit të Strategjisë të Policisë së Kosovës dhe udhëzuesi që ka përmbledhur të gjitha aktivitetet në procesione të inteligjencës. Ndërsa, sa i përket Raportit të Progresit për Kosovën, për vitin 2015, theksi që policimi i udhëhequr nga inteligjenca, nuk ka vlerësim negativ, por ka sugjerim avancues, sidomos për format e krimit të organizuar, por edhe vlerësimi ynë është që duhet gjetur modalitete për ristrukturimin formal të të gjitha agjencive të zbatimit të ligjit, për t’iu qasur konceptit “polici e udhëhequr nga inteligjenca”. Më tutje, theksoi se ka ngecje në bazën e të dhënave të gjyqësorit. Duke iu referuar raportit për krimin e organizuar, i quajtur “SOTKA”, i cili publikohet nga INTERPOL-i, çdo katër vjet, theksoi se nga ana e Policisë së Kosovës është bërë përpjekje që të kenë raportin e dytë të tillë. Lidhur me zbatimin e Strategjisë së policimit nga inteligjenca, theksoi se nga vlerësimi i vitit të kaluar, që është bërë, janë të kënaqur pasi nuk ka pasur ngecje dhe theksoi që objektivat në vazhdimësi i kanë dy qëllime, deri në përfundim të strategjisë në fuqi. Qëllim i parë është që çdoherë bartësit dhe aktorët kryesorë, që merren me realizim të objektivave të caktuara, të avancojnë dhe në anën tjetër të përfitohet koha që të bëhen analiza, prej ndikimeve të ndryshme, deri tek edukimi për ngritjen e kulturës së sigurisë, që nënkupton sensin për informacion dhe nevojën e informimit në rrugë të drejtë rreth rasteve të çfarëdo shtate apo personi, që mund të jetë në kundërshtim me ligjin.

Nuredin Ibishi- Shtroi pyetjet si në vijim: Cili është plani i juaj pas vitit 2017? Cili do të jetë orientimi juaja para hartimit të strategjisë afatmesme, cilët do të jenë indikatorët?

Bojan Mitiq- Duke iu referuar fjalës së z. Rexha, që Policia e Kosovës ka një strategji që ka disa objektiva, shtroi pyetjen si vijon: Çfarë përmbajnë këto objektiva, sqarime shtesë?

Kryesuesi- Shtroi pyetjet si në vijim: Rezultatet e arritura, a janë rezultatet e pritura? A konsideroni që mekanizmat e sigurisë kanë qenë të gatshëm për të zbatuar një strategji të tillë?

Naim Rexha, zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (koordinator Kombëtar)- Në përgjigje të pyetjeve të z. Nuredin Ibishi, theksoi se pas 2017-s, do të vazhdohet sipas planit strategjik zhvillimor të Policisë së Kosovës. Element kyç është shfrytëzimi i vlerësimeve strategjike vjetore të Policisë së Kosovës, fokusimi në kanosjet dhe rreziqet për sigurinë e vendit. Aspekti i strukturimit formal dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me Policinë e Kosovës, mendohet si mjet për realizimin e qëllimit. Pra, infrastruktura e ndërtuar në kuadër të Policisë së Kosovës, që është në funksion të këtij koncepti, duhet të ndërtohet me agjencitë e tjera, pasi që për trajtimin e informatës është kushti i domosdoshëm i rrjetit të brendshëm të komunikimit. Ndërsa, bashkëpunimi i filluar dhe i cili do të vazhdojë me agjencitë e tjera, do të

arrijë njohuritë e nevojshme për trajtimin e informacioneve. Qëllimi është që pas 2017-s, strategjia sektoriale të ngrihet në grupin e strategjive nacionale dhe jemi të vetëdijshëm çfarë duhet bërë pas 2017-s, pra fokusimi në veçoritë e caktuara, sepse në vlerësimin e fundit të Policisë së Kosovës, bie në sy ndërthurja kriminale, që nënkupton se tashmë prej fazës së grupeve kriminale, në kuadër të veprimtarisë së caktuar kriminale, kemi tendencë të rritjes së grupeve kriminale, me aplikim të formave të shumta të krimit.

Çështja e tretë, vlerësimi dhe puna në parandalimin e efekteve indirekte të nivelit global të sigurisë, në të cilin nuk është më vetëm çështja e vlerësimit të terrorizmit, sepse ka kanosje dhe rreziqe të tjera në nivelin global. Ndërsa, të vetëdijshëm për handikapun e pamundësisë sonë për të qenë pjesë e iniciativave rajonale dhe ndërkombëtare, siç janë INTERPOL dhe EUROPOL, dhe pavarësisht vlerësimeve ndërkombëtare që janë plotësuar kriteret për anëtarësim, ende duhet të presim për disa vendime formale. Më tutje, përmendi objektivat strategjike si në vijim: Fuqizimi i kapaciteteve, që i referohet ri-dizajnit të sistemit të mëparshëm informativ në një sistem të integruar informativ të Policisë së Kosovës, sistemi PRIMIS, që i shërben menaxhmentit të Policisë së Kosovës për përcjelljen e gjendjes përbrenda organizatës, në raport me burimet njerëzore. Objektivi i dytë, është avancimi i sistemit të teknologjisë informative dhe komunikimit; objektivi i tretë, fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit; dhe objektivi i katërt, i cili zhvillohet paralelisht me të arriturat nga tri objektivat e përmendura, është zbatimi praktik i procesit të inteligjencës. Ndërsa, sa i përket rezultateve, nuk kanë qenë skeptike, pasi përpos vlerësimeve vjetore, realizojnë takime çdo tre muaj. Gjithashtu, përmendi edhe rastin e zëvendësimit të kutive për pasimin e informacioneve për stacionet policore, në kuadër të sistemit informativ të Policisë së Kosovës, ku çdo zyrtar policor ka mundësi qasjeje për të dërguar informacionin e caktuar në adresën e caktuar, brenda strukturave të implementimit të këtij koncepti.

Gjithashtu, theksoi se kultura e ulët e sigurisë së shoqërisë sonë, është edhe njëri nga elementet që ndikon sadopak në çështjet e sigurisë, pasi janë shumë struktura që bëjnë kërkesa për asistime, siç është rasti për faturat e energjisë elektrike.

Kryesuesi- Vlerësoi prezantimin e bërë nga ana e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe konsideroi që përkrahja e Komisionit në fushën e ligjeve, do të jetë gjithëherë e gatshme.

Artan Dreshaj, drejtor i Departamentit për Administrim të Sistemeve dhe Komunikimeve në MPB - Theksoi që është i autorizuar nga koordinatori Nacional për Strategjinë për Siguri Kibernetike, të raportojë për këtë strategji, e cila ka një shtrirje kohore 2016-2019. Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë: mbrojtja e infrastrukturës kritike të informacionit, zhvillimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve, ndërtimi i partneritetit publiko-privat, reagimi ndaj incidenteve dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Më tutje, theksoi se në kuadër të planit të veprimit, parashihen edhe objektivat që duhet të arrihen, me qëllim të realizimit të objektivave të strategjisë. CEP (Computer Emergency Response Team) nacional është krijuar, që nënkupton ekipet kompjuterike të reagimeve emergjente, në rast të sulmeve dhe për parandalimin tyre. Gjithashtu, theksoi se janë në proces të krijimit të disa CEP-ve të tjerë, në nivel institucional në Policinë e Kosovës, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe në kuadër të Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar trajnime të ndryshme në këtë fushë.

Nuredin Ibishi- Shtroi pyetjet si në vijim: Kur do të kompletohen ekipet reaguese dhe kur do të jenë funksionale? A është policia kompetente në fazën e parë në rastet e kërcënimeve për raste të caktuara?

Ganimete Musliu- Cilat janë rastet më të shpeshta të krimeve kibernetike? Sa raste hetohen brenda vitit?

Qerim Bajrami- Kërkoi sqarim për termin CEP.

Artan Dreshaj, drejtor i Departamenti për Administrim të Sistemeve dhe Komunikimeve në MPB- Në përgjigje të z. Nuredin Ibishi, theksoi se sipas planit të veprimit të Strategjisë për sigurinë kibernetike, pritet që gjatë vitit 2016, të gjitha CEP-të të jenë funksionale. Më tutje, theksoi se ka qenë një projekt trans-rajonale i Komisionit Evropian “Enhancing Cyber Security”, pjesë e të cilit kanë qenë Kosova, Maqedonia dhe Moldavia, ku Kosovës i është mundësuar që të marrë serverët e gatshëm, që bëjnë analiza të ndryshme. Ndërsa, fjala CEP është term nga gjuha angleze- *Computer Emergency Response Team* dhe në gjuhën shqipe është Ekipet Kompjuterike për Reagime Emergjente.

Fadil Abdyli, shef i Sektorit për Hetime, Krime Kibernetike në Policinë e Kosovës- Sa i përket pyetjeve të shtruara, për rastet e kërcënimeve të personaliteteve të caktuara përmes internetit, theksoi se sektori të cilin përfaqëson, është përgjegjës për disa lloje të tjera të veprave, por në rastet e kërcënimeve të caktuara, është ofruar mbështetje. Më tutje, theksoi se nuk është i lehtë identifikimi i kryerësve, pasi përmes përdorimit të internetit janë mundësuar më të mëdha për fshehjen.

Ndërsa, në përgjigje të pyetjes se cilat janë rastet më të shpeshta, theksoi se janë veprat e keqpërdorimit të pornografisë me fëmijë, hyrjet në sistemet kompjuterike, si dhe keqpërdorimi i kartelave bankare të kreditit. Më tutje, theksoi se duke mos qenë anëtar të Këshillit të Evropës, Kosova nuk ka arritur të jetë anëtare e Konventës së Budapestit për krime kibernetike. Më tutje, theksoi se veprat e tjera të cilat janë paraqitur, kanë qenë publikimet e lajmeve të rrejshme përmes emaileve, publikimet e paautorizuara, cenimi i të drejtave të autorit, kartelat bankare të vjedhura dhe klonuara, mashtrime përmes falsifikimit të emaileve. Në vitin 2013, kanë qenë trembëdhjetë raste të falsifikimit të emailit, 2014 njëzet e katër raste, ndërsa në vitin 2015, tetëdhjetë e katër raste. Gjithashtu, theksoi se nga drejtoria e tyre është ofruar bashkëpunim edhe për raste të tjera që nuk kanë qenë kompetencë e tyre.

Nuredin Ibishi- Ngriti çështjen e kërcënimeve përmes rrjeteve sociale. Çfarë ndërmerr Policia e Kosovës në raste të tilla?

Ganimete Musliu- Shtroi pyetjen si vijon: A ka pasur raste të denoncimit për thirrjet telefonike nga interneti nga ana e qytetarëve? Nëse po, si trajtohen rastet e tilla?

Fadil Abdyli, shef i Sektorit për Hetime, Krime Kibernetike në Policinë e Kosovës- Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara, theksoi se rastet e kërcënimeve nuk janë drejtpërdrejt në përgjegjësinë e sektorit të cilin përfaqëson, por ofrojnë mbështetje për hetimin e këtyre veprave. Më tutje, theksoi se është i vështirë identifikimi i rasteve që përdorin internetin përmes rrjeteve sociale, për të kërcënuar ose për vepra të tjera. Gjithashtu, theksoi se kompanitë e caktuara që

ofrojnë internet, janë të obliguara të ruajnë të dhënat e përdoruesve, në afat gjashtëmuor. Po ashtu, problematike mbetet çështja kur IP-adresat janë jashtë territorit të Kosovës. Ndërsa, sa i përket numrit të veprave, kanë qenë tridhjetë e katër raste të hapura dhe 118 raste në nivel të stacioneve të drejtorive të tjera, në kuadër të Policisë së Kosovës.

Artan Dreshaj, drejtor i Departamentit për Administrim të Sistemeve dhe Komunikimeve në MPB - Theksoi se Strategjia për Siguri Kibernetike, është në përputhje me standardet e Agjencisë Evropiane për Sigurinë në Rrjete dhe Telekomunikacion. Ndërsa, sa i përket parandalimit, theksoi se funksionimi i CEP-ve është një mekanizëm që e mundëson një gjë të tillë. Gjithashtu, theksoi se në kuadër të strategjisë, janë paraparë fushata të vetëdijesimit. Më tutje, theksoi se me formimin Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetike, do të ndërmerren disa veprime që do të parandalojnë veprimet e sulmeve kibernetike.

Nuredin Ibishi- Shtroi çështjen e mundësisë së bllokimit dhe ndërprerjes së faqeve të caktuara, me qëllim të parandalimit të sulmeve të caktuara ndaj një personi.

Fadil Abdyli, shef i Sektorit për Hetime, Krime Kibernetike në Policinë e Kosovës- Theksoi se për ndërprerjen e faqeve të caktuara, kjo gjë është e mundur, por duhet një urdhëresë nga Prokuroria dhe mund të mbyllet një faqe e caktuar e internetit. Ndërsa, sa i përket bllokimit të profileve në facebook, theksoi që kjo gjë mund të bëhet vetëm nga rrjeti social facebook, ndërsa nga ana e tyre kërkohet ofrimi i provave për një profil të caktuar.

Kryesuesi- Falënderoi për prezantimin dhe raportimin nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Kosovës.

4. Të ndryshme

Ganimete Musliu- Njoftoi për vizitën e realizuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, më datë 26.4.2016, ku është takuar me z. Ismail Smakiqi, drejtor i Përgjithshëm i Akademisë dhe dekanin e Fakultetit të Sigurisë Publike, z. Nazmi Iballi, ku është njoftuar njohur nga afër me punën dhe aktivitetet në këtë institucion, si dhe është informuar lidhur me spekulimet nga mediat rreth përdorimit ose jo të simboleve shtetërore, ku është konfirmuar se gjithëherë simbolet e Republikës së Kosovës janë të vendosura në këtë institucion.

Nuredin Ibishi- U bëri ftesë partive opozitare që të jenë pjesë e Kuvendit dhe Komisionit. Gjithashtu, kërkoi që Komisioni të jetë aktiv në aspektin e zhvillimeve aktuale në fushën e sigurisë.

Kryesuesi- Me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:03.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku